



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Erpower" Sh.P.K. të datës 08.08.2025 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 06.08.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "106 Instalimi i Elektrikes - Furnizimi, zevendesimi dhe montimi i transformatorit 400 kWA" me nr. të prokurimit 616-25-5432-1-3-6, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Erpower" Sh.P.K. të datës 08.08.2025 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 06.08.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "106 Instalimi i Elektrikes - Furnizimi, zevendesimi dhe montimi i transformatorit 400 kWA" me nr. të prokurimit 616-25-5432-1-3-6 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i datës 06.08.2025 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Erpower" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 08.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 06.08.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "106 Instalimi i Elektrikes - Furnizimi, zevendesimi dhe montimi i transformatorit 400 kWA" me nr. të prokurimit 616-25-5432-1-3-6.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Oferta e kompanisë fituese nuk pasqyron një çmim real dhe të bazuar në treg për transformatorin energjetik me fuqi 400 kVA sipas kerkese se KEDS ku kjo diferenc mes çmimit të ofertuar dhe çmimit të tregut tregon difference ekstreme midis çmimit të ofertës dhe çmimit të tregut sugjeron ofertë spekulative, duke shkelur rregullat për prokurime të qëndrueshme".

Tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmim i cili është 30% më i ulët sesa mesatarja e çmimeve nga 3 ofertat e përgjegjshme si dhe 10% më e ulët sesa çmimi i dytë më i lirë. Në kuptim të nenit 41.3 dhe 41.6 të RRPP kërkesa për rishqyrtim është gjetur si pjesërisht e bazuar pasi që AK duhet të zhvilloj procedurën inter partes me tenderuesin e rekomanduar për të konfirmuar nëse çmimet e ofertuara janë jonormalisht të ulëta ose jo si dhe nëse këto çmime janë të mjaftueshme për të realizuar me sukses projektin.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 11.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.